



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.704/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përbarimore të kreditorit, N.T EL-SHPËTIMI me seli ne Podujevë rr. “Ilir Konushevci”, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.665/22 i datës 13.02.2023, me datë 24.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit Komuna e Prishtinës, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.665/22 i datës 13.02.2023, ashtu që çështja gjykohet si në vijim:

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, i paraqitur kundër urdhrit përbarimor P.nr.539/21 i datës 23.06.2021 i lejuar nga përbaruesi privat Eset Murati, dhe ANULOHET Urdhri përbarimor P.nr.539/21 i datës 23.06.2021 i përbaruesit privat Eset Murati

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles së Parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.665/22 dt.13.02.2023, e ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përbarimit P.nr.539/21 dt.23.06.2021, i Përbaruesit Privat Eset Murati, dhe ka lënë në fuqi Urdhrin përbarimor P.nr.539/21 dt.23.06.2021.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak te cenimit thelbësor te dispozitave te procedurës kontestimore dhe përbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Dhoma e shkallës se dytë ta aprovoj ankesën e debitorit dhe aktvendimin e atakuar ta ndryshoj ashtu që propozimin për përbarim ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.T “EL-SHPETIMI” me seli ne Podujevë rr. “Ilir Konushevc, me datë 23.06.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Komuna e Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.010/2021 dt.06.04.2021, 111/2021 dt.07.04.2021, 118/2021 dt.07.04.2021. Përmbartuesi Privat Eset Murati, Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.539/2021 dt.23.06.2021, ka lejuar përmbartimin, me te cilin ka detyruar debitorin që kreditorit t’ia paguaj borxhin nga fatura ne shumen prej 740.60 euro me kamatë prej 8% nga dita e caktimit te përmbartimit e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet përmbartimore.

Debitori ka parashtruar prapësim me datë 29.06.2021, duke theksuar se urdhri për përmbartim është i pabazuar dhe i palejuar, i paqëndrueshëm, sepse nuk është i mbështetur ne asnjë dispozitë ligjore dhe se faturat nuk përbejnë titull përmbartimor, te njëjtat nuk janë dokumente përmbartuese siç shihet me nenin 29 te LPP, janë te njëanshme, nuk janë pranuar dhe nënshkruar nga personat e autorizuar, po ashtu janë kopje, dhe nuk i plotësojnë kushtet esenciale te parapara me nenin 29 te LPP. Nuk dihet se ne çfarë baze ligjore kreditori e kërkon detyrimin ndaj debitorit pasi i njëjti nuk ka bashkangjitur asnjë kontratë me te cilën tregohet raporti juridik i kreditorit dhe debitorit, pasi ne kontratë faturimi është ne kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, andaj burimi i faturave është i panjohur, faturat janë dërguar ne institucione parashkollore te cilat nuk mund te kryejnë pagesa pa pasur kontratë, andaj meqë faturat nuk kanë edhe numrin e protokollit, te njëjtat nuk i plotësojnë kushtet ligjore për tu ekzekutuar, andaj propozon qe gjykata ta pranoj prapësimin e debitorit, ta shfuqizoj urdhrin për lejimin e përmbartimit, ta refuzoj si te pabazuar propozimin për përmbartim dhe ta detyroj kreditorin qe debitorit te përmbartimit ti paguaj shpenzimet e përpilimit te prapësimi.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit ka paraqitur kreditori me datën 01.07.2021, me arsyetimin se përmbartuesi privat e ka caktuar përmbartimin ne pajtim me nenin 29 te LPP, faturat janë pranuar nga debitori ndërsa nga ana e tij nuk ka pasur denoncim te njëjtave. Shkaqet e prapësimi te debitorit janë te parapara me nenin 71 te LPP ndërsa debitori ne prapësim nuk ka ofruar prova me te cilat do ti mbështeste pretendimet e tij, propozon që gjykata ne përputhje me nenin 73.3 te LPP ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi.

Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, përgjigjes ne prapësim dhe shkresave ne lëndë ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.665/22 dt.13.02.2023, me të cilin e ka Refuzuar ne tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbartimor. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka gjetur se faturat ne bazë te cilave është lejuar urdhri përmbartimor i plotësojnë te gjitha kushtet për te qene

dokument i besueshëm dhe janë të përshtatshme për përmburim sipas nenit 29 të LPP. Gjykata në këtë rast i referohet edhe nenit 37 të LPP, sepse në fatura janë treguar palët, mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj marrëveshje, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmburje nga ana e debitorit si dhe koha e përmburjes, andaj nga këto arsye gjykata ka gjetur se nuk ekziston asnjëra nga bazat e parashikuara me nenin 71 të LPP ashtu që në kuptim të nenit 73 të LPP ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga një vërtetim i tillë i gabuar i gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, nga dhoma e shkallës së parë, e cila fare nuk është lëshuar në elementet vendimtare të faturave përmburimore nr.010/2021 dt.06.04.2021, 111/2021 dt.07.04.2021, 118/2021 dt.07.04.2021, bashkangjitur propozimit për përmburimit të kreditorit, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi se për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, në rastin konkret nuk është aplikuar drejt ligji, sepse nuk kemi një dokument të besueshëm dhe të përshtatshëm që i plotëson kushtet ligjore nga neni 21 dhe 29 të LPP-së. Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi se në shkresat e lëndës nuk ka prova se këto fatura të lëshuara nga kreditori, janë të nënshkruara apo pranuar nga debitori.

Udhëzimi administrativ nr.15/2010 par Zbatimin e Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 20 par.1 nënpar.1.17 parasheh që: *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, e që në rastin konkret faturat për të cilën kreditori kërkon përmburjen e detyrimit, nuk ka prova se është e pranuar nga debitori, të njëjtat nuk janë të vullosura nga ana e tij, në mënyrë që të konsiderohet si dokument i besueshëm. Gjendja faktike e këtyre faturave përmburimore qëndron në faktin se ato janë vullosur dhe nënshkruar nga institucioni parashkollor “Botanika”, “Milingonat”, dhe në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë tjetër që dëshmon se këto fatura janë pranuar pikërisht nga debitori, prandaj faturat e vullosura dhe nënshkruar nga këto dy institucione parashkollore, që kanë shërbyer si dokumente për përmburim, janë në kundërshtim me Propozimin për përmburim i datës 23.06.2021, ku kreditori ka kërkuar përmburjen e detyrimit ndaj debitorit Komuna e Prishtinës.

Andaj, Dhomat e shkallës së dytë, nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e dhomës së shkallës së parë se fatura e kreditorit është dokument i besueshëm i lejuar për përmburim. Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të pranohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të shfuqizohet Urdhri për lejimin e përmburimit nga ana e Përmburuesit privat Eset Murati, P.nr.539/21 datës 23.06.2021. Dhomat e shkallës së dytë nuk mund ta pranojë qëndrimin e dhomës së shkallës së parë, për faktin se kjo e fundit gabimisht ka nxjerr konstatimin se faturat përmburimore bashkangjitur propozimit për përmburim janë të përshtatshme për përmburim. Kjo gjykate pranon pretendimet ankimore se fatura mbi të cilën është lejuar urdhri për lejimin e përmburimit nuk mund të jetë e pambarueshme pasi që nuk është pranuar në mënyrë të rregullt dhe as nënshkruar nga debitori, dhe në këtë rast konsiderohet se debitori nuk e ka pranuar borxhin e pretenduar nga kreditori.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 pika (c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.704/23 me datë 24.01.2024

Gjyqtari
Krenar Berisha